

Njoftim publik mbi kërkesat e IPARD II në lidhje me Regjistrin Kombëtar të Fermës për Masën 1 dhe Masën 7.

Për shkak të një gabimi konceptual në hartimin e Udhëzimit për Aplikantët, një informacion jo i duhur u dha në lidhje me kërkesat e Programit IPARD II nën masën 1 dhe masën 7.

Programi IPARD II kërkon që të gjithë marrësit të jenë: "Fermerë, qoftë persona fizikë ose persona juridikë, përfshirë kooperativat, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të përfshirë në Regjistrin Kombëtar të Fermës."

Në Udhëzuesin për Aplikantët informacioni nuk u transmetua me qartësinë e duhur pasi Regjistri Kombëtar i Fermave nuk është i plotë. Në Udhëzues thuhet se aplikantët duhet të pajisen me NIPT-in e Fermerit për qëllimet e kriterëve të mësipërme.

Në mënyrë që të respektohen kërkesat e Programit IPARD, të mbrohen interesat financiare të BE-së dhe për të siguruar vazhdimësinë e shqyrtimit të aplikimeve në lidhje me masën 1 dhe masën 7:

Të gjithë aplikantët e prekur, të cilët kanë paraqitur vetëm NIPT-in e Fermerit, do t'ju kërkohet të sigurojnë një certifikate nga Zyrat e AREB, ku të kenë të deklaruar aktivitetin e tyre bujqësor dhe të jenë të regjistruar si fermer në Regjistrin Rajonal të Fermës. Kërkesa do të dërgohet individualisht me postë gjithashtu do të përfshijë kërkesat e AZHBR për plotësimin e dokumentacionit, si rrjedhojë e vlerësimit të rregullt të aplikimeve.

Që nga dita e marrjes së njoftimit, do të jepet 15 ditë kohë kalendarike për të paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar, duke përfshirë dhe certifikatën e AREB.

AZHBR ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar përparësi absolute nga zyrat e AREB për procesin dhe disponueshmërinë e plotë për të siguruar që të gjitha certifikatat të lëshohen me kërkesë të aplikuesit në kohën e duhur.